

Gjyqi i prokurores Donika Prele në KPA shtyhet për në shtator

Prokurorja përballet me kërkesën për shkarkim për shkak të pikëpyetjeve mbi pasurinë, dorëzoi një raport mjekësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të hënën duke kërkuar shtyrjen e seancës për periudhën e raportit si dhe për periudhën e pushimeve të gushtit.

Autor: [Gjergj Erebara](#) | BIRN | Tiranë



Ish-drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Renda, Donika Prele në seancën e parë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
Foto arkivë: LSA

Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi të hënën të shtyjë për datën 3 shtator çështjen e prokurores Donika Prele pasi kjo e fundit paraqiti një raport mjekësor për të justifikuar mungesën si dhe kërkoi që çështja e saj të shqyrtohet pas pushimeve të gushtit.

“Për arsye shëndetësore, ju lutem pranoni kërkesën për shtyrje seance,” shkroi Prele në letrën e saj, e cila u dorëzua nga bashkëshorti.

“Gjithashtu, ju lutem merrni parasysh se muaji gusht është muaj pushimesh për sistemin gjyqësor,” shtonte letra.

Komisioneri Publik Florian Ballhysa e la në çmim të gjykatës vendimin dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit e pranoi atë duke caktuar datën 3 shtator për seancën e ardhshme.

Prela u [konfirmua](#) në detyrë në shkurt 2019 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mes debateve të shumta politike. Ajo është akuzuar nga Partia Demokratike për lidhje me krimin ndërsa komisioneri publik apeloj vendimin e konfirmimit duke kërkuar shkarkimin e saj.



RRETH AUTORIT

Gjergj Erebara

Gjergj Erebara është gazetar për BIRN në Tiranë. Ai ka mbaruar studimet për gazetari në Universitetin e Tiranës dhe ka master shkencor (MSC) për Histori Ekonomike nga Universiteti i Lundit. I specializuar për gazetari ekonomike. Erebara ka punuar që nga viti 1998 në disa media të shkruara dhe vizive Shqiptare, si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor.